

REZISTENCA NDAJ EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM PËRMES EDUKIMIT

*Udhërrëfyes për nxënësit, mësuesit dhe prindërit
për të njohur shenjat e para të radikalizimit të të rinjve*



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian

University College
BEDËR

ISD

Preventing new
generations
against extremism

 **Centre for
Common Ground**

 **Terre des hommes**
Helping children worldwide. tdh.ch

ASP AKADEMIJA
STUDIMEVE
POLITIKE

PRILL 2018

Për të përgatitur në shqip këtë udhërrëfyes që synon të shpjegojë në mënyrë sa më praktike ekstremizmin e dhunshëm dhe masat mbrojtëse ndaj tij janë përdorur studimeve dhe materiale të ndryshme promovuese të publikuara nga Këshilli i Evropës, UNESCO, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, USAID, Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm etj.

Shënim:

Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian në kuadër të skemës së granteve të vogla të projektit “Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Rritjen e Reziliencës së të Rinjve ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm” i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Terre des Hommes Shqipëri në partneritet me ISD, CCG dhe Universitetin Bedër.

Përmbajtja e tij është përgjegjësi e Akademisë së Studimeve Politike dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian”.

© Copyright 2018, Akademia e Studimeve Politike

Permbajtja

Përkufizime	5
Hyrje	6
Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi	7
Ekstremizmi dhe terrorizmi.....	9
Angazhimi i të rinjve ndaj ekstremizmit.....	10

Udhërrëfyti për mësuesit 12

Pyetje dhe përgjigje për mësuesit	13
Mesazhet kryesore	15
Cilat janë detyrat e mësuesit për parandalimin e ekstremizmit?	16
Cilat janë shenjat e para të radikalizimit?	18
Cilët janë të rinjtë më të prekshëm ndaj radikalizmit?	19
Si të reagoj nëse kam një shqetësim për një nxënës?	20

Udhërrëfyti për prindërit 22

Pyetje dhe përgjigje për prindërit	22
Përse është i rëndësishëm ekstremizmi për mua si prind?	22
Si duhet të flas me fëmijën tim për ekstremizmin?	23
Çfarë duhet të bëj për të mbrojtur fëmijën tim nga radikalizimi?	24

Si mund ta mbaj fëmijën tim të sigurtë nga ekstremizmi online?	25
Radikalizmi online	25
A është i prekshëm fëmija im ndaj radikalizmit?	26
Cilat janë shenjat e para të radikalizimit?	28
Çfarë duhet të bëj nëse mendoj se fëmija im është radikalizuar?	29
Bibliografi	31

Përkufizime

Sjellje anti-sociale: Sjellje që kërcënon atmosferën e sigurt të shkollës dhe përfshin, por nuk kufizohet vetëm në sjellje të tilla si bullizmi, ngacmimi, diskriminimi, racizmi, sjellja e paligjshme ose kriminale, dhuna fizike ose dëmtimi i shkollës ose objekteve të tjera.

Ekstremizmi: Kur një person ose grupim beson në pikëpamje, të cilat mendohen të paarsyeshme dhe të papranueshme nga shumica tjetër e njerëzve.

Ekstremizmi i dhunshëm: Kur një person ose grupim mendon që frika, terrori dhe dhuna janë mjete të justifikueshme për të arritur ndryshime ideologjike, politike ose shoqërore dhe më pas vepron mbi këto besime.

Radikalizimi: Procesi me të cilin një person adopton pikëpamje apo praktika ekstreme deri në pikën e legjitimitetit të përdorimit të dhunës.

Terrorizmi: Veprime apo një strategji e veçantë që përdoret për të arritur një objektiv ideologjik, politik ose shoqëror duke krijuar dhe shfrytëzuar qëllimisht frikën.

Hyrje

Ekstremizmi i dhunshëm dhe forcat që nxisin radikalizimin janë ndër sfidat më të vështira të ditëve tona. Të rinjtë janë posaçërisht të cenueshëm ndaj mesazheve të ekstremistëve të dhunshëm dhe organizatave terroriste. Përballë këtyre kërcënimeve, ata kanë nevojë për t'u informuar dhe edukuar me qëllim që të zhvillojnë njohuritë për të qënë rezistentë ndaj një propagande ekstremiste.

Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm përmes edukimit duhet të jetë pjesë e një përpjekjeje më të gjerë parandaluese, në të cilën të përfshihet jo vetëm shkolla dhe mësuesit, por sigurisht edhe familja, komuniteti dhe media. Komunitetet, ku janë ndërtuar struktura të koordinimit mes aktorëve të ndryshëm, ku ekziston mbështetja sociale dhe aktivizimi i të rinjve të marginalizuar, janë më të sigurt ndaj rrezikut të përfshirjes në sjellje ekstremiste të të rinjve.

Çdo person mund të jetë i ekspozuar dhe i prekshëm nga rrëfimet ekstremiste, edhe pse ka faktorë që mund të bëjnë që disa të jenë më të prekshëm se të tjerët. Interneti po përdoret gjithnjë e më shumë nga grupet ekstremiste si mjet për të arritur ndjekës, duke pretenduar se mund të ofrojnë zgjidhje për problemet e përditshme në familje e shoqëri. Të rinjtë, të cilët janë përdorues më të shumtë të internetit, por edhe mund t'i besojnë me lehtë këtyre premtimeve, nevojitet që të kenë informimin e duhur si dhe ndihmën nga strukturat e tjera në komunitetin e tyre.

Ky udhërrëfyes synon që të informojë të rinjtë, mësuesit dhe prindërit mbi këtë temë të rëndësishme si dhe të ofrojë disa këshilla për të krijuar rezistencën e duhur ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi

Ekstremizmi i dhunshëm lidhet me ato besime dhe veprime që mbështesin ose përdorin dhunën e motivuar ideologjikisht për të ngulitur pikëpamje ideologjike, fetare ose politike radikale

Pikëpamjet e ekstremizmit të dhunshëm mund të shfaqen në një sërë çështjesh, duke përfshirë dhe marrëdhëniet politike, fetare dhe gjinore. Asnjë shoqëri, komunitet fetar ose pikëpamje botërore nuk është immune ndaj një ekstremizmi të tillë të dhunshëm.

Ekstremizmi i dhunshëm cilësohet situata kur ... “ti nuk lejon pikëpamje të ndryshme;

kur mendon se pikëpamjet e tua janë të veçanta, kur nuk lejon mundësinë e të ndryshmes

dhe kur do t’ua imponosh idetë e tua të tjerëve, nëse është e nevojshme, edhe përmes dhunës”

Megjithëse për termin “**radikalizim**” ka qëndrime të ndryshme, ai po përdoret për të përkufizuar procesin përmes të cilit, një individ ose grup e vlerëson dhunën si legjitime dhe si mjet të dëshirueshëm veprimi.

Për radikalizimin nuk ka një përcaktim ose drejtim të vetëm, si-kurse nuk mund të përcaktohet as shpejtësia me të cilën ai mund të përhapet. Megjithatë, pranohet ndikimi i faktorëve socialë, ekonomikë, psikologjikë dhe institucionalë, të cilët të shtyjnë drejt ekstremizmit të dhunshëm.

Specialistët i grupojnë këta faktorë në dy kategori kryesore:

“Faktorët shtytës” që i drejtojnë individët drejt ekstremizmit të dhunshëm, të tillë si: marxhinalizimi, pabarazia, diskriminimi, persekutimi ose perceptimi i persekutimit; mundësia e kufizuar për arsim cilësor dhe të përshtatshëm; mohimi i të drejtave dhe lirive civile; dhe probleme të tjera mjedisore, historike dhe socialekonomike.

“Faktorët tërheqës” që ushqejnë tërheqjen ndaj ekstremizmit të dhunshëm, si për shembull: ekzistenca e grupeve të mirëorganizuara të ekstremizmit të dhunshëm me ligjërime imponuese dhe programe efektive, të cilat ofrojnë shërbime, të ardhura dhe/ose punësim në këmbim të anëtarësimit. Grupet mund të joshin anëtarë të rinj duke iu ofruar zgjidhje për problemet dhe duke iu premtuar aventurë dhe liri. Për më tepër, këto grupe duket se ofrojnë rehati shpirtërore, “ndjenjën e përkatësisë” dhe një rrjet social mbështetës.

Së fundi, ekzistojnë faktorë kontekstualë të cilët ofrojnë një terren të favorshëm për shfaqjen e grupeve të ekstremizmit të dhunshëm, të tillë si: shtetet e brishta, mungesa e shtetit të së drejtës, korrupsioni dhe kriminaliteti.

Disa shembuj të ekstremizmit të dhunshëm:

- Grupet neonaziste,
- Ku Kluks Klani,
- Ekoterrorizmi,
- Shteti Islamik i Irakut dhe Levantit (ISIL apo ISIS),
- Organizata Boko Haram

Ekstremizmi dhe terrorizmi

Terrorizmi dhe ekstremizmi ndonjëherë përdoren në mënyrë të ndërsjellë. Të dy paraqesin një kërcënim për të rinjtë, por ata kanë përkufizime të dallueshme.

Terrorizmi është një veprim apo kërcënim i projektuar për të ndikuar mbi qeverisjen ose për të frikësuar publikun. Qëllimi i tij është të avancojë një çështje politike, fetare ose ideologjike.

Legjislacioni shqiptar e përcakton terrorizmin si më poshtë terrorizmin:

- Rrezikon jetën e një personi, përveç atij të personit që kryen veprimin
- Përfshin dhunë serioze ndaj një personi
- Shkakton dëme serioze të pronës
- Krijon një rrezik serioz për shëndetin dhe sigurinë e publikut
- Ndërhyn apo shkatërron seriozisht një sistem elektronik

Është e rëndësishme të mbani mend se jo të gjitha grupet ekstremiste (qoftë fetare, të ekstremit të djathtë apo të rrymave të tjera) kanë si synim të kryejnë akte terroriste ose të dhunshme. Megjithatë, disa grupe paraqesin kërcënime të veçanta, si në terren ashtu edhe në internet.

Angazhimi i të rinjve ndaj ekstremizmit

Të rinjtë mund të nxiten të shfrytëzojnë energjinë dhe entuziazmin që i karakterizon për të krijuar dhe zhvilluar ide pozitive dhe zgjidhje të reja për sfidat e ekstremizmit të dhunshëm si dhe shqetësimet e tjera globale. Me njohuritë që kanë për krijimin e lidhjeve përmes mediave sociale, ndarja e përvojave ndërmjet tyre bëhet menjëherë realitet dhe ka potencial për t'u përhapur gjerësisht.

Shpesh, proceset demokratike të vendimmarrjes mund të gjykojnë si tepër të ngadalta për të rinjtë, të cilët parapëlqejnë veprim të menjëhershëm. Për këtë arsye, duhet të identifikohen mënyra të shpejta për të krijuar ndryshim dhe ndikime pozitive në komunitet.

Përfshirja në proceset vendimmarrëse në nivelin lokal e qendror ose pjesëmarrja në veprimtari vullnetare ndihmojnë edhe në kultivimin e dëshirës së të rinjve dhe energjisë së tyre për ndryshim. Përmes pjesëmarrjes aktive në organizatat rinore dhe grupet informale, por edhe aktivitete sportive e kulturore, të rinjtë janë në gjendje të ushqejnë ndjenjën e shpresës, identitetit, shoqërisë dhe përkatësisë, të cilat i angazhojnë ata më shumë me komunitetin dhe i largojnë nga qasja ekstremiste.

Nxitja e shumëllojshmërisë së ideve dhe diskutimit mbi to ndërmjet nxënësve zvogëlon gjasat për zhvillimin e sjelljeve konfrontuese dhe ideologjive radikale. Studimet e fundit në këtë fushë nënvizojnë faktin se diskutimi i tematikave dyzuese, veçanërisht prirjet radikalizuese, duhet të inkurajohet në vend që të shtypet nga mësuesit. Duhet prezantuar nëpër ambjentet shkollore ideja se normat dhe vlerat ndryshojnë në kultura të ndryshme, në mënyrë që të promovohet mendimi kritik, shumëllojshmëria dhe përfshirja.

Studimet dhe përvoja e deritanishme ka treguar se fokusimi i ndërrhyrjes vetëm në grupe të caktuara, nuk është një qasje efikase për parandalimin e fenomenit. Kjo qasje rrit ndjesinë e marginalizimit (trajtimit jo si të rëndësishëm) dhe mos përkatësisë, inkurajon

fragmentimin dhe demonizon një grup të caktuar. Ndaj përfshirja në trajnime apo diskutime e të gjithë të rinjve është më efikas në arritjen e ndryshimeve pozitive.

Udhërrëfyesi për mësuesit

Shkollat duhet të jenë hapësira të sigurta, ku nxënësit mund të diskutojnë çështje të ndryshme sociale dhe të aktualitetit, duke përfshirë ekstremizmin dhe terrorizmin. Të rinjtë janë posaçërisht të cenueshëm ndaj mesazheve të ekstremiste dhe në këtë moshë ata kanë nevojë për t'u informuar dhe edukuar për të qënë rezistentë ndaj këtyre nxitjeve të rrezikshme.

Roli i arsimit në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm është pranuar gjerësisht së fundi në nivel global, por edhe në strategjitë dhe qasjen e qeverisë shqiptare ndaj këtij fenomeni.

Më konkretisht arsimi mund t'i ndihmojë të rinjtë:

- ▶ Të zhvillojnë aftësitë e komunikimit dhe ato ndërpersonale që u nevojiten për të dialoguar, për t'u përballur me mosmarrëveshjet dhe të mësojnë qasjet paqësore ndaj ndryshimit;
- ▶ Të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik, për të shqyrtuar pretendimet, për të qartësuar thashethemet dhe për të vënë në pikëpyetje legjitimitetin dhe kërkesat për besime ekstremiste;
- ▶ Të zhvillojnë aftësi për t'iu rezistuar ideve e qëndrimeve ekstremiste dhe për të përfutur aftësitë social-emocionale që ju duhen, për të kapërcyer dyshimet që kanë dhe për t'u angazhuar në mënyrë konstruktive në shoqëri, pa qenë nevoja për t'iu drejtuar dhunës;
- ▶ Të formojë qytetarë të informuar, të aftë për të marrë pjesë në mënyrë konstruktive në aktiviteteve kolektive

paqësore.

Edukimi i nxënësve mbi rezistencën ndaj ekstremizmit kërkon mësues që kanë besim tek vetja, janë të përgatitur mirë, të respektuar dhe në kontakt të vazhdueshëm me të rinjtë. Mësuesit duhet kujdesen që të pajisin nxënësit me aftësitë dhe njohuritë e duhura për të eksploruar çështjet politike dhe sociale në mënyrë kritike, për të gjykuar provat, për të debatuar dhe për të zhvilluar diskutime të arsyetuara. Kjo mund të përfshijë lehtësim në bashkëbisedim rreth ekstremizmit dhe radikalizimit në një moshë të përshtatshme, ashtu si edhe në çështje sociale dhe politike.

Pyetje dhe përgjigje për mësuesit

Si t'i edukoj nxënësit mbi ekstremizmin?

Ka shumë lëndë të cilat mundësojnë një diskutim të frytshëm rreth ekstremizmit të dhunshëm. Sfida që shtrohet është si të formulohet tema në mënyrë të tillë që t'u vijë në ndihmë nxënësve për të eksploruar vlerat dhe opinionet e tyre dhe për të menaxhuar përgjigjet emocionale, ndërkohë që kuptojnë më mire idetë bazë të ideologjive ekstreme.

Ndër këto lëndë përmendim:

► **Qytetaria** – Mundëson nxënësit të trajtojnë çështjet e të drejtave dhe të përgjegjësisë në shoqëri të ndryshme, çështje të drejtësisë, të identitetit dhe të nocionit të “përkatësisë”. Tema ofron edhe mundësi për të debatuar rreth parimeve themelore të të drejtave të njeriut dhe për të identifikuar dhe luftuar gjuhën e urrejtjes.

► **Historia** – Edukimi rreth historisë së gjenocidit dhe barbaritë në masë, të tilla si Holokausti, janë të rëndësishme për t'i përfshirë nxënësit në reflektimin rreth fuqisë së propagandës së urrejtjes dhe të rrënjëve të racizmit, antisemitizmit dhe dhunës politike. Po ashtu, historia iu lejon nxënësve të eksplorojnë mënyrën e krijimit dhe të ndërtimit të shkrimeve historike dhe sesi ato mund të përjetësojnë konfliktin dhe paragjykimin në shoqëritë përkatëse.

► **Feja dhe besimet** – Kjo shërben për të rritur vetëdijen dhe respektimin e diversitetit brenda komunitetit dhe për të ofruar mundësi për eksplorimin e vlerave dhe besimeve të ndryshme, duke sfiduar, në këtë mënyrë, paragjykimin dhe racizmin. Këtu duhet të përfshihet diskutimi për sekularizmin (parimi i ndarjes së institucioneve shtetërore nga besimi dhe institucionet fetare) dhe humanizmin, për t'iu përgjigjur miteve që njësojnë sekularizmin dhe ateizmin dhe dyshimit ndaj “jo besimtarëve”. Duhet të theksohet se besimtarët në një rajon të caktuar nuk duhet të stereotipizohemi të gjithë të njëjtë, kur shpesh brenda një feje ka më shumë diversitet sesa ndërmjet feve të ndryshme. Është e rëndësishme që në diskutim të përfshihen dhe nxënësit që nuk kanë besime fetare.

► **Gjuhët** – Ndhmon nxënësit të zbulojnë një gamë të gjerë kulturash, vlerash dhe pikëpamjesh për historinë dhe mendimin botëror. Përveç zhvillimit të aftësive bazë të shkruarit dhe të argumentimit me gojë, gjuhët ndihmojnë për të zhvilluar edhe njohuritë për median.

► **Liria e shprehjes dhe interneti** – Ndhmon për të eksploruar me nxënësit mënyrën: si ofrohet, strukturohet dhe transmetohet informacioni; si mund të manipulohet informacioni për qëllime të dhunshme; si konkurrojnë burimet e reja të informacionit me median profesionale. Trajtimi i njohurive të medias *online* do t'u vijë në ndihmë nxënësve të përdorin internetin dhe median sociale në mënyrë të sigurt dhe të efektishme. Kjo mund të lidhet me edukimin për qytetari për të drejtat e njeriut dhe me dallimin ndërmjet fjalimeve të lira dhe të ligjshme dhe fjalimeve të urrejtjes.

► **Barazia gjinore dhe dhuna me bazë gjinore** – Kjo temë ndihmon për të kuptuar shkakun kryesor të problemit; për të sfiduar sjellje të ndryshme rreth statusit dhe rolit të grave; për të fuqizuar njësoj si djemtë dhe vajzat për përdorimin e masave konstruktive, jo të dhunshme kundër argumenteve ekstremiste që nxisin dhunën kundër vajzave dhe grave.

► **Arti** – Ndhmon për të nxitur të kuptuarit dhe vlerat e popujve, të kulturave dhe të shprehjeve kulturore të ndryshme nga tonat. Arti mund të shihet si një gjuhë universale që i lidh komunitetet dhe kulturat në kohë dhe hapësirë. Ai ofron mundësinë për të debatuar sesi mohimi dhe shkatërrimi i trashëgimisë kulturore dhe artistike, për shkak të ekstremizmit të dhunshëm, përbën humbje për të gjithë njerëzimin.

Mesazhet kryesore

Mund të transmetoni njohuritë e duhura tek nxënësit ndaj nxitjeve ekstremiste duke i pajisur ata me aftësitë për të eksploruar çështjet politike dhe sociale në mënyrë kritike, për të gjykuar provat, për të debatuar dhe për të ofruar argumente të arsyetuara. Kjo mund të përfshijë lehtësim në bashkëbisedim rreth ekstremizmit dhe radikalizimit në një moshë të përshtatshme, ashtu si edhe në çështje sociale dhe politike.

Mesazhet kryesore në këto diskutime duhet të promovojnë të drejtat themelore të mbrojtura nga Kushtetuta dhe të konventat ndërkombëtare si:

- **Demokracia**
- **Sundimi i ligjit**

- **Të drejtat e njeriut**
- **Toleranca fetare**

Është e rëndësishme të diskutohen çështje rreth identitetit, diversitetit dhe tolerancës. Temat shoqërore duhet të jenë të shtjelluara në mënyrë të qartë për të nxitur vlerat tradicionale shqiptare si mikpritjen e të huajve dhe tolerancën ndërfaqetare dhe etnike, që ka shfaqur historikisht kombi ynë.

Më shumë udhëzime dhe informacion për zhvillimin e diskutimeve në klasën tuaj mund të gjeni në kurrikulën e përgatitur për mësuesit nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të titulluar “**Të parandalojmë ekstremizmin e dhunshëm**”:

<http://izha.edu.al/new/wp-content/uploads/2018/02/10.-UN-ESCO-Udhezues-per-mesuesit-per-parandalimin-e-ekstremizmit-te-dhunshem.pdf>

Cilat janë detyrat e mësuesit për parandalimin e ekstremizmit?

Mbrojtja e nxënësve nga rreziku i radikalizmit është pjesë e rëndësishme e funksionit të shkollës për të siguruar një ambjent të qetë në brendësi të saj, por edhe një shoqëri të sigurtë në përgjithësi. Përballë rritjes së rrezikut të radikalizimit, është e rëndësishme që të jeni të përgatitur se si të mbroheni nga ky kërcënim.

Studiuesit bien dakord që përgjigja më e mirë institucionale ndaj ekstremizmit është parandalimi dhe jo kundërshtimi i dhunshëm nëpërmjet dënimeve ligjore. Parandalimi në shkolla nuk duhet të paragjykohet si “spionim” i nxënësve apo ndërhyrje në punët e brendshme të familjes së tyre. Duhet të jeni të sigurtë se veprimi i

mësuesit është i domosdoshëm për të identifikuar shenjat e para të ekstremizmit të nxënësve përpara se ata të kthehen në një rrezik për nxënës të tjerë në shkollë dhe komunitetin.

Më poshtë disa hapa brenda detyrës suaj si mësues për të parandaluar ekstremizmin në shkollën tuaj:

- Vlerësoni rrezikun e radikalizimit të nxënësve në shkollën tuaj
- Sigurohuni që mund të keni një përgjigje të përshtatshme në rast nevojë
- Mbani nën kontroll rrjetin e internetit në laboratorët e informatikës apo klasat e tjera
- Bisedoni me autoritetet lokale dhe policinë për të marrë informacion praktik, për të kuptuar rreziqet në zonën tuaj
- Ndërtoni marrëdhënie të qëndrueshme komunikimi me prindërit dhe komunitetin
- Ndiqni trajnimet përkatëse dhe informohuni mbi ngjarjet politike dhe sociale

Cilat janë shenjat e para të radikalizimit?

Nuk ka vetëm një rrugë drejt radikalizmit. Megjithatë, ka disa tipare të sjelljes që mund të tregojnë se nxënësi juaj është ekspozuar ndaj radikalizimit. Radikalizimi i të rinjve mund të ndodhë gjatë një periudhe të gjatë kohore. Në disa raste ky fenomen nxitet nga një ngjarje ose një incident i caktuar dhe mund të ndodhë shumë më shpejt. Ndonjëherë ka shenja të qarta të radikalizimit, në raste të tjera ndryshimet janë më pak të dukshme.

Mosha e adoleshencës është koha e ndryshimit të madh dhe të rinjtë, që shpesh duan të jenë të pavarur, lehtësisht shprehin ndjenjën e zemërimit dhe shpeshherë të mosbesimit ndaj autoriteteve. Kjo e bën të vështirë për të dalluar sjelljen normale të adoleshencës dhe qëndrimin që tregon se fëmija juaj mund të ketë qenë i ekspozuar ndaj ndikimeve të radikalizimit.

Sjelljet e mëposhtme të renditura këtu synojnë të ndihmojnë në identifikimin e radikalizimit të mundshëm:

Pamja e jashtme

- Argumentimi i detajuar i qëndrimeve kundërshtuese
- Refuzimi për të dëgjuar pikëpamje të ndryshme
- Refuzimi për t'u shoqëruar me fëmijë të ndryshëm nga ata
- Sjellje abuzive ndaj fëmijëve që janë të ndryshëm
- Përqafimi i teorive të konspiracionit
- Ndjenja e persekutimit
- Ndryshimi i miqësive dhe pamjes së jashtme
- Largimi nga shokët e vjetër
- Mosbërja e aktiviteteve që më parë dëshironin

- Konvertimi në një fe të re
- Hezitimi për të treguar vendndodhjen e tyre
- Simpatia ndaj ideologjive dhe grupeve ekstremiste

Sjellje online

- Ndryshimi i identitetit në internet
- Pasja e më shumë se një identiteti online
- Shpenzimi shumë kohë në internet ose në telefon
- Përdorimi i përmbajtjes ekstremiste në internet
- Bashkimi ose përpjekja për t'u bashkuar me një organizatë ekstremiste

Ju i njihni nxënësit tuaj më mirë, kështu që jeni të parët që vini re nëse ata veprojnë jashtë karakterit të tyre. Besoni dhe kini besim në gjykimin tuaj profesional, dhe merrni këshilla nëse ndjeni që diçka nuk po shkon siç duhet.

Cilët janë të rinjtë më të prekshëm ndaj radikalizmit?

Çdo nxënës mund të jetë i prekshëm nga ekstremizmi. Është e rëndësishme të njihni faktorët që i bëjnë nxënësit tuaj më të prekshëm ndaj radikalizmit. Në vijim janë renditur disa faktorë kryesorë, por sigurisht përdorni gjykimin tuaj profesional për të vlerësuar ndjeshmërinë e nxënësve.

- Distancimi nga prejardhja kulturore ose fetare
- Pyetja për vendin që zënë në shoqëri
- Çështjet familjare

- Përjetimi i një ngjarje traumatike
- Përjetimi i racizmit ose diskriminimit
- Vështirësi në marrëdhëniet shoqërore
- Vështirësi në kuptimin e pasojave të veprimeve të tyre
- Vetëvlerësim i ulët

Secila nga këto çështje i bën nxënësit më të prirur të besojnë se pretendimet e ekstremistëve janë përgjigje ndaj problemeve të tyre.

Faktorët e jashtëm luajnë gjithashtu rolin e tyre, siç janë: tensionet e komunitetit, ngjarjet që prekin vendin ose rajonin ku ata ose prindërit e tyre janë, ose kanë miq ose familje që u janë bashkuar grupeve ekstremiste. Ekspozimi ndaj pikave të njëanshme të të gjithëve kontribuon në procesin e radikalizimit. Ata të rinj të përfshirë në grupe kriminale, ose që kanë pasur vështirësi për t'u riintegruar pas burgimit ose një institucioni të ri shkelës, mund të jenë gjithashtu në rrezik.

Si të reagoj nëse kam një shqetësim për një nxënëse?

Nëse jeni të shqetësuar për një nxënëse, i cili mund të jetë radikalizuar, ju duhet të ndiqni fillimisht standartet e shkollës edhe për çështje të tjera problematike. Fillimisht duhet të njoftohet mësuesi kujdestar, drejtuesi i shkollës dhe psikologu. Së bashku, mund të diskutoni shqetësimin tuaj me prindërit e nxënësit. Në rast se e mendoni të nevojshme, mund të kërkonit ndihmën e bordit të prindërve dhe strukturave të tjera të nxënësve, të cilat mund të angazhohen për të diskutuar situatën dhe ofruar zgjidhje të mundshme.

Në rast se shihet e nevojshme, nuk duhet të hezitoni të ftoni në takime edhe punonjësin e policisë të zonës suaj si dhe liderë të tjerë fetarë apo komunitarë (administratorin, kryeplakun apo persona të tjerë me reputacion në komunitetin tuaj). Duke kontaktuar autoritet nuk fusni në telash asnjë nxënës përse kohë nuk është kryer asnjë akt kriminal. Përfaqësuesit e komunitetit dhe të policisë do të diskutojnë shqetësimet tuaja duke ju dhënë përkrahje dhe këshilla përkatëse.

Që prej muajit dhjetor 2017 është ngritur dhe funksionon pranë Këshillit të Ministrave **Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm** (www.cvecenter.al). Ky institucion koordinon në nivel kombëtar dhe lokal ndërhyrje në komunitetet në nevojë për rastet e radikalizmit dhe të ekstremizmit të dhunshëm. Në vijim do të jetë e mundur që të gjeni më shumë informacion dhe kontakte të kësaj Qendre se ku mund të kërkonti ndihmë të mëtejshme mbi nxënësit tuaj të prekur nga ekstremizmi.

Udhërrëfyesi për prindërit

Pyetje dhe përgjigje për prindërit

Përse është i rëndësishëm ekstremizmi për mua si prind?

Radikalizimi dhe rekrutimi i të rinjve në grupe ekstremiste është një shqetësim në rritje. Çdo fëmijë mund të jetë i prekshëm ndaj rrëfimeve ekstremiste, edhe pse ka faktorë që mund të bëjnë që disa fëmijë të jenë më të prekshëm se të tjerët. Si prind, duhet të jeni të vetëdijshëm se individët dhe grupet me pikëpamje ekstremiste përdorin internetin dhe mediat sociale për të përhapur ideologjitë e tyre. Fëmijët shpenzojnë shumë kohë në internet dhe kjo i ka bërë më të ndjeshëm ndaj ekstremizmit.

Grupet ekstremiste kontaktojnë me të rinj të cilët shfaqin pasiguri. Ata shpesh pretendojnë të ofrojnë përgjigje dhe premtojnë një ndjenjë identiteti që shpesh kërkojnë të rinjtë në nevojë. Si pjesë e strategjisë së tyre të rekrutimit, grupet ekstremiste gjithashtu punojnë për të minuar autoritetin e prindërve. Kjo mund të jetë veçanërisht tërheqëse për fëmijët vulnerabël, të cilët nuk kanë udhëzimet e duhura prindërore, ose që vijnë nga familje me probleme.

Grupet ekstremiste përdorin gjithashtu metoda shumë të sofistikuara për të nxitur ndjenja të zemërimit, padrejtësisë dhe turpit që një fëmijë mund të ndjejnë ndaj një prindi.

Por është e rëndësishme të mbani mend se çdo fëmijë mund të preket nga ekstremizmi. Ju mund të luani një rol jetësor duke ofruar mbështetje emocionale, e cila vepron si një alternativë ndaj narrativës (propagandës) ekstremiste. Nuk është e lehtë të flisni me fëmijën për rreziqet e ekstremizmit, por si për çështje të tilla si

seksi dhe droga, është e nevojshme. Jepni fëmijës tuaj një hapësirë të sigurt ku mund të flasin për tema të vështira. Sa më shumë që flisni, aq më i sigurt do të jetë fëmija juaj ndaj propagandës ekstremiste.

Si duhet të flas me fëmijën tim për ekstremizmin?

Nuk është asnjëherë e lehtë për të filluar një bashkëbisedim me një fëmijë. Në qoftë se do të tregoheni mjaft i ashpër, fëmija juaj mund të stepet dhe reagojë në mënyrë të gabuar. Gjithashtu nëse do të tregoheni tepër delikate, mund të përfundoni duke diskutuar diçka krejtësisht tjetër. Është e rëndësishme të përgatiteni paraprakisht se ku dhe si duhet ta trajtoni çështjen e ekstremizmit me fëmijën tuaj. Zgjidhni një ambient ku fëmija juaj të ndihet i qetë. Zgjidhni kohën e përshtatshme ku të mos keni ndërprerje nga të tjerë.

Më poshtë po ju japim disa udhëzime të dobishme:

► Krijojini fëmijës një ambient ku të ndihet i qetë

Bëjeni bisedën në mënyrë të tillë që fëmija të ndihet i qetë dhe miqësor me ju. Mundohuni të jeni i ekuilibruar dhe i drejtë në gjykimin me fëmijën.

► Inkurajojeni të bëjë pyetje

Pyeti ata rreth çështjeve që kërkojnë më shumë se përgjigjet PO ose JO. Një gjë e tillë të jep mundësinë të kuptoni atë çka ata mendojnë në të vërtetë. Për shembull, nëse ju shikoni diçka në televizor rreth ekstremizmit, mund të pyesni fëmijën tuaj se çfarë do të bënin nëse do ta gjenin veten në atë situatë. Ose për të

treguar se e vlerësoni mendimin e tyre, mund të thoni se një mik i juaj ka nevojë për këshilla rreth ekstremizmit. Pyesni fëmijën çfarë mendojnë rreth kësaj situate. Në këtë mënyrë mësoni, se sa janë të informuar mbi këtë temë.

► **Ofrojini mundësinë të flasin pa e ndërprerë**

Lërimi ata të flasin pa i ndërprerë nga ju si dhe nga familjarë të tjerë që mund të rëndojnë situatën më ndërhyrjen e tyre.

► **Më e rëndësishmja sigurisht: Dëgjojeni**

Është e rëndësishme që fëmija juaj të dijë se ata mund të flasin në mirëbesim me ju. Nëse ata nuk ndjehen rehat duke folur me ju, sugjeroni që ata të flasin me njerëz të tjerë që ata kanë besim.

Çfarë duhet të bëj për të mbrojtur fëmijën tim nga radikalizimi?

Të qenit i sigurtë me fëmijën tuaj dhe të flisni me të në mënyrë sistematike është mënyra më e mirë për të garantuar mbrojtjen e duhur nga influenza e ekstremizmit.

Diskutimet rreth seksit dhe drogës me fëmijën tuaj janë të vështira, por të domosdoshme. Është e rëndësishme të bisedoni me ta edhe për ekstremizmin dhe radikalizmin. Dhënia e fakteve dhe argumentave për këto tema të vështira do t'i ndihmojnë ata të jenë më të informuar dhe pajisur për të sfiduar idetë ekstremiste.

Mos harroni se edhe fëmijët e vegjël mund të ekspozohen ndaj ekstremizmit në internet. Përpjekja për të ndaluar fëmijën që të përdorë internetin nuk do t'i mbajë ata të sigurtë. Në vend të kësaj mase ekstreme, mësojuni fëmijëve të kuptojnë se jo cdo gjë që thuhet në një faqe interneti është e vërtetë.

Si mund ta mbaj fëmijën tim të sigurtë nga ekstremizmi online?

Fëmijët nuk kanë nevojë të takojnë njerëz të tjerë që të përfshihen nga bindjet ekstremiste. Interneti po përdoret gjithnjë e më shumë nga grupet ekstremiste për të radikalizuar të rinjtë. Këto grupe shpesh mund të ofrojnë zgjidhje të rreme për problemet e përditshme në familje e shoqëri apo marginalizimin (trajtimit jo si të rëndësishëm) e të rinjve.

Radikalizmi online

Diskutoni me fëmijën tuaj për sigurinë dhe rrezikun që ekziston gjatë lundrimit në internet dhe sigurohuni që llogaria personale etyre në mediat sociale të jetë e siguruar. Instaloni programe të kontrollit prindëror në pajisjet elektronike me qëllim monitorimin e faqeve online apo grupeve chat që përdorin.

Më poshtë do të gjeni disa sygjjerime, të cilat ju ndihmojnë për të mbajtur fëmijën të sigurtë:

► Bisedoni me fëmijën tuaj për aktivitetin e tyre në internet

Shpesh fëmijët nuk i gjykojnë si të huaj njerëzit që kanë takuar në internet përmes rrjeteve sociale dhe lojrave në internet – ata janë vetëm miq në internet. Tregojuni se është shumë më e lehtë që njerëzit të gënjejnë në internet sesa në jetën reale. Idealja është që të jeni miq me fëmijën tuaj në mediat sociale, por nëse ata nuk kanë dëshirë, atëherë kërkojini një shoku ose një anëtar të familjes që të provojë të jetë miku i tyre. Kërkojuni t’ju tregojnë disa nga faqet e tyre të preferuara.

► Tregoni interes se cilët janë miqtë e tyre

Pyetini fëmijët se si vendosin se cilët të jetë miq me ta. Cili është

kriteri i tyre për zgjedhjen e miqve? Si i gjejnë ata dhe përse kanë kaq shumë? Mos kini frikë t'i pyesni, pasi është e rëndësishme për të diskutuar mbi sigurinë në internet me ta.

► **Bini dakort mbi limitin e kohës që kalojnë në internet dhe faqet që vizitojnë**

Bini dakort për disa rregulla bazë së bashku. Konsideroni limitin e kohës që mund të qëndrojnë në internet, faqet e internetit që vizitojnë dhe aktivitetet në të cilat marrin pjesë.

► **Mendoni të instaloni programe të kontrollit prindëror në pajisjet e tyre**

Kontrolloni cilësimet e privatësisë në llogaritë e medias sociale të fëmijës tuaj për të ruajtur informacion personal të pamundur për t'u aksesuar publikisht. Bisedoni me ta rreth masave që duhet të marrin nëse dikush i kontakton me mesazhe apo video shqetësuese.

► **Sigurohuni që ata të dinë se si të raportojnë abuzimin në internet**

Shumë faqe online kanë mekanizma për të raportuar abuzim - sigurohuni që fëmijët t'i njohin këto mekanizma.

A është i prekshëm fëmija im ndaj radikalizmit?

Fëmijët nga të gjitha llojet e prejardhjeve mund të bëhen të radikalizuar. Këtu janë disa nga faktorët e përbashkët, të cilët i bëjnë ata të pambrojtur.

Si prind, sigurisht është e mundur që ju do të dalloni ndonjë nga këta faktorë ose ndryshime në sjelljen e fëmijës, përpara kujtdo

tjetër dhe do të jeni në gjendje të përdorni gjykimin tuaj për të ditur nëse fëmija juaj është i prekshëm. Sjelljet e mëposhtme janë një udhëzues dhe është e rëndësishme të mbani mend se kushdo mund të preket nga ekstremizmi:

- Distancimi nga prejardhja kulturore ose fetare
- Pyetja për vendin që zënë në shoqëri
- Çështjet familjare
- Përjetimi i një ngjarje traumatike
- Përjetimi i racizmit ose diskriminimit
- Vështirësi në marrëdhëniet shoqërore
- Vështirësi në kuptimin e pasojave të veprimeve të tyre
- Vetëvlerësim i ulët

Secila nga këto çështje i bën fëmijët më të prirur të besojnë se pretendimet e ekstremistëve janë përgjigje ndaj problemeve të tyre.

Faktorët e jashtëm luajnë gjithashtu rolin e tyre, siç janë: tensionet e komunitetit, ngjarjet që prekin vendin ose rajonin ku jetojnë, ose nëse kanë miq apo familjarë që u janë bashkuar grupeve ekstremiste. Ekspozimi ndaj këndvështrimeve të njëanshme të ngjarjeve kontribuon në procesin e radikalizimit. Ata fëmijë të përfshirë me grupe kriminale, ose që kanë pasur vështirësi për t'u riintegruar pas burgimit, gjithashtu mund të jenë në rrezik.

Cilat janë shenjat e para të radikalizimit?

Nuk ka vetëm një rrugë drejt radikalizmit. Megjithatë, ka disa tipare të sjelljes që mund të tregojnë se fëmija juaj është ekspozuar ndaj radikalizimit. Radikalizimi i të rinjve mund të ndodhë gjatë një periudhe të gjatë kohore. Në disa raste ky fenomen nxitet nga një ngjarje ose një incident i caktuar dhe mund të ndodhë shumë më shpejt. Ndonjëherë ka shenja të qarta të radikalizimit, në raste të tjera ndryshimet janë më pak të dukshme.

Mosha e adoleshencës është koha e ndryshimit të madh dhe të rinjtë, që shpesh duan të jenë të pavarur, lehtësisht shprehin ndjenjën e zemërimit dhe shpeshherë të mosbesimit ndaj autoriteteve. Kjo e bën të vështirë për të dalluar sjelljen normale të adoleshencës dhe qëndrimin që tregon se fëmija juaj mund të ketë qenë i ekspozuar ndaj ndikimeve të radikalizimit.

Sjelljet e mëposhtme të renditura këtu synojnë të ndihmojnë në identifikimin e radikalizimit të mundshëm:

Pamja e jashtme

- Argumentimi i detajuar i qëndrimeve kundërshtuese
- Refuzimi për të dëgjuar pikëpamje të ndryshme
- Refuzimi për t'u shoqëruar me fëmijë të ndryshëm nga ata
- Sjellje abuzive ndaj fëmijëve që janë të ndryshëm
- Përqafimi i teorive të konspiracionit
- Ndjenja e persekutimit
- Ndryshimi i miqësive dhe pamjes së jashtme
- Largimi nga shokët e vjetër

- Mosbërja e aktiviteteve që më parë dëshironin
- Konvertimi në një fe të re
- Hezitimi për të treguar vendndodhjen e tyre
- Simpatia ndaj ideologjive dhe grupeve ekstremiste

Sjellje online

- Ndryshimi i identitetit në internet
- Pasja e më shumë se një identiteti online
- Shpenzimi shumë kohë në internet ose në telefon
- Përdorimi i përmbajtjes ekstremiste në internet
- Bashkimi ose përpjekja për t'u bashkuar me një organizatë ekstremiste

Pavarësisht këtyre shenjave, ju e njihni fëmijën tuaj më mirë se kushdo tjetër, kështu që besojini instiktin tuaj nëse ndjeni se diçka nuk po shkon siç duhet. Ju jeni personi, i cili mund të dalloni nëse fëmija juaj është duke u sjellë në mënyrë të ndryshme nga normalja.

Çfarë duhet të bëj nëse mendoj se fëmija im është radikalizuar?

Nëse jeni të shqetësuar se fëmija juaj po radikalizohet, duhet të reagoni në kohë. Biseda me fëmijën tuaj është një mënyrë e mirë për të vlerësuar nëse instinktet tuaja janë të sakta, por mund të preferoni që së pari të ndani dyshimet tuaja me dikë tjetër.

Biseda me fëmijën tuaj rreth ekstremizmit dhe radikalizimit mund të jetë e sikletshme, por këshillimi është një mënyrë lehtësuese që

të filloni bisedën me ta.

Nëse dëshironi të flisni me dikë tjetër para se të bisedoni me fëmijën tuaj, ka një numër mundësish, njerëzish dhe organizatash që mund të drejtoheni për ndihmë dhe këshillë.

Ngrini çështjen me mësuesit e fëmijës suaj, një mik ose një anëtar të ngushtë të familjes. Shpjegoni shqetësimet tuaja dhe zbuloni nëse ata kanë vënë re diçka jashtë normales. Dëgjimi i një perspektive tjetër mund t'ju ndihmojë të vendosni nëse ajo që keni konstatuar është e gabuar apo jo. Organizoni një takim me mësuesin kujdestar/psikologun dhe drejtuesin e shkollës së fëmijës suaj. Ata do të jenë në gjendje t'ju këshillojnë në mënyrën më të mirë.

Mund të kontaktoni gjithashtu nëse e cilësoni të nevojshme edhe policinë apo drejtuesit e tjerë të komunitetit. Duke kontaktuar autoritet nuk e fusni në telashe fëmijën tuaj përse kohë nuk është kryer asnjë akt kriminal. Përfaqësuesit e komunitetit dhe të policisë do të diskutojnë shqetësimet tuaja duke ju dhënë përkrahje dhe këshilla përkatëse.

Që prej muajit dhjetor 2017 është ngritur pranë Këshillit të Ministrave **Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm** (www.cvecenter.al). Ky institucion koordinon në nivel kombëtar dhe lokal ndërhyrje në komunitetet në nevojë për rastet e radikalizmit dhe të ekstremizmit të dhunshëm. Në vijim do të jetë e mundur që të gjeni më shumë informacion dhe kontakte të kësaj Qendre se ku mund të kërkonti ndihmë të mëtejshme mbi nxënësit tuaj të prekur nga ekstremizmi.

Bibliografi

Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm – “Guidë referuese për mësuesit” Mundësuar nga CIJA dhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë

Këshilli i Evropës – “Compass: Manual për edukimin e të rinjve mbi të drejtat e njeriut” - <https://www.coe.int/en/web/compass/violence-in-my-life>

Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar - “Edukim kundër urrejtjes” - <https://educateagainsthate.com/parents/what-are-the-warning-signs/>

UNESCO-“Të parandalojmë ekstremizmin e dhunshëm”, Guidë udhëzuese për mësuesit - <http://izha.edu.al/new/wp-content/uploads/2018/02/10.-UNESCO-Udhezues-per-mesuesit-per-parandalimin-e-ekstremizmit-te-dhunshem.pdf>

USAID, Përmbledhje e faktorëve që kanë ndikim mbi ekstremizmin e dhunshëm. http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PBAAA929.pdf;

Zeiger, S. dhe Aly, A. 2015. Luftimi i ekstremizmit të dhunshëm: zhvillimi i një baze provash për politikatat dhe praktikatat. Curtin University, Hedayah.¹²

